



Në përputhje me Nenin 10 dhe Nenin 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.13. të Ligji Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ndryshuar dhe plotësuar me Ligji Nr. 08/L-138, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) njofton:

**Shpallje
për
një (1) Praktikant**

15/09/2026

Numri i referencës: 01/2026

Informacion i përgjithshëm

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (në tekstin e mëtejshëm referuar si "FKGK") është entitet i pavarur juridik, i krijuar me ligj përkatës për të lehtësuar qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Kosovë me synimin e krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimeve të cilat krijojnë vlerë të shtuar, përmirësim të bilancit tregtar dhe rritje e mundësive për financimin e NMVM-ve.

Përshkrimi i përgjegjësisë:

Praktikanti do të angazhohet në kuadër të strukturës organizative të FKGK-së dhe do të punojë nën mbikëqyrjen e stafit përgjegjës, duke kontribuar në realizimin e aktiviteteve të përditshme të institucionit.

Angazhimi do të përshtatet me profilin profesional të praktikantit dhe me nevojat aktuale për zhvillim dhe mbështetje brenda institucionit.

Kualifikimet dhe shkathtësitë:

- Të ketë përfunduar, apo të jetë në përfundim të studimeve universitare në vend/jashtë vendit (preferohet të ketë përfunduar së paku vitin e dytë)
- Departamentet e Fakultetit Ekonomik ose Juridik (fusha të ngjashme)
- Studentë me notë mesatare mbi 8.5
- Të jetë në gjendje të punojë në grup dhe individualisht
- Të ketë njohuri shumë të mira të programeve MS Office
- Të zotërojnë gjuhën angleze.

Afati dhe kohëzgjatja

Praktikantit do t'i ofrohet kontratë gjashtë (3-6) mujore dhe do të jetë i vendosur në zyrë të FKGK-së në Prishtinë.

Aplikimi

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni për punësim (shkarkoni nga <https://fondikgk.org/mundesipunesimi/>);
- Diploma / Regjistri i notave, Certifikata dhe trajnime nëse ka;

Të gjitha aplikacionet do të pranohet vetëm përmes emailit **recruitment@fondikgk.org** dhe në subjektin e emailit duhet të shkruhet: **"Formë Aplikimi: Emri dhe Mbiemri_Pozita"**

Konkursi është i hapur deri me datë **29.09.2026** ora **16.30**.